

VENDIM
Nr.20, datë 10.6.1998

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli	Anëtar i""
Kristofor Peçi	Anëtar i""
Kujtim Puto	Anëtar i""
Sokol Sadushi	Anëtar i""
Alfred Karamuço	Anëtar i""
Franc Jakova	Anëtar i""

Me sekretare Arta Palushi më datë 10.6.1998 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.8 Akti, që i përket:

KËRKUESE: SHOQATA KOMBETARE PER KTHIMIN E PARAVE TE LENE ME FAJDE, e përfaqësuar nga kryetari i saj, Mistret Sahiti.

SUBJEKTI I INTERESUAR: Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministri i Drejtësisë Thimio Kondi.

OBJEKTI:

Deklarimi antikushtetues i vendimit nr.501, datë 24.11.1997 të Këshillit të Ministrave.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi përfaqësuesin e subjektit të interesuar, (kërkuesi ishte në mungesë) dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Nga materialet e dosjes rezulton se Gjykata e Rrethit Tiranë me vendimin nr.681, datë 24.02.1998 ka vendosur shpërndarjen e Shoqatës Kombëtare për Kthimin e Parave të Lëna me Fajde. Ky vendim, sipas shënimit të bërë në thembër të tij, ka marrë formë të prerë më datë 10.03.1998 për paditësin (Grupin Mbikëqyrës pranë Këshillit të Ministrave) dhe më datë 06.04.1998 për të paditurin (Shoqatën Kombëtare për Kthimin e Parave të Lëna me Fajde).

Në këto rrethana, Gjykata çmon se ish-Shoqata Kombëtare për Kthimin e Parave të Lëna me Fajde, me shpërndarjen e saj e ka humbur cilësinë e personit juridik për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, sipas nenit 25 të Ligjit nr.7561, datë 29.04.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në Ligjin nr.7491, datë 29.04.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese".

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 24 e vijues të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", unanimisht,

VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.